

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6258
E hënë, 8 mars 2021
çmimi 0.40 €

Ndërron jetë profesor Zejnullah Gruda



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SHTOHEN DYSHIMET PËR MANIPULIM TË VOTAVE NË ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE TË 14 SHKURTIT

KËRKOHEM RINUMËRIMI I VOTAVE



Disa kandidatë për deputetë të subjekteve të ndryshme politike kanë kërkuar rinumërim të tërësishëm të votave. Kërkesa e tyre ka ardhur pas publikimit të një videoincizimi, në të cilin pretendohet se burri i kryediplomates Meliza Haradinaj-Stublla ka blerë vota në bashkëpunim me disa komisionarë në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR). Demokracia në Veprim (DnV) i ka bërë thirrje Prokurorit të Shtetit që t'i nisë menjëherë hetimet rreth dyshimeve për falsifikim të votave brenda QNR-së. Ndërsa Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka komunikuar me prokurorinë, duke u shprehur i gatshëm për bashkëpunim rreth zbardhjes së rasteve për manipulim të votave

AKTUALE



SBASHK-u, INSTITUCIONEVE: ARSIMI TË JETË PRIORITET F.7

NËNTË TË VDEKUR DHE 548 RASTE TË REJA ME COVID NË KOSOVË F.6

DIALOGU ME MARRËVESHJE TË NEGLIZHUARA F.3

EKONOMI



GAP-i: VENDIMET PËR THEMELIMIN E ZONAVE EKONOMIKE KANË QENË TË MOTIVUARA POLITIKISHT F.9

TATIMET E PRODUKTEVE PËRBËJNË PJSËN MË TË MADHE TË TË HYRAVE QEVERTARE F.9

KULTURË

PROMOVHET MONOGRAFIA "SHKOLLAT DHE ARSIMI NË KËRPIHEH ME RRETHINË PËRGJATË KOHËRAVE" F.10

EKSPERTËT E EKONOMISË: CEFTA DUHET TË KETË VËMENDJE PËR MOSTRAJTIM TË BARABARTË

Ekspertë të ekonomisë, përfaqësues të bizneseve vendore dhe ndërkombëtare, Safet Gërshaliu, Burim Piraj dhe Emrush Ujkani, kanë kërkuar që të rinegociohen Marrëveshja e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë (CEFTA) dhe Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA), pasi prodhuesit e Kosovës vazhdojnë të pengohen nga Serbia dhe Bosnje Hercegovina



DIALOGU ME MARRËVESHJE TË NEGLIZHUARA

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Senati amerikan miraton paketën e ndihmës

UASHINGTON, 7 MARS - Projektligji i presidentit amerikan Joe Biden, për t'iu ndihmuar amerikanëve që të përballen me pasojat e pandemisë së koronavirusit, ka kaluar një pengesë të madhe. Plani prej 1.9 trilion dollarësh amerikanë është miratuar të shtunën në Senat

ani pse republikanët kanë votuar kundër. Dhoma e Përfaqësuesve, e kontrolluar nga demokratët e Bidenit, pritet të miratojë këtë plan të martën e javës së ardhshme. Bideni e ka përshkruar votën në Senat si "një tjetër hap gjigant përpara", teksa është zotuar

për t'iu ndihmuar njerëzve. Kriza më e keqe shëndetësore në një shekull në Shtetet e Bashkuara ka lënë gati 523 000 persona të vdekur, mbi 29 milionë të infektuar dhe ka rezultuar me një shkallë të papunësisë prej 6.2-përqindësh. Paketa e ndihmës, e treta në

Shtetet e Bashkuara, prej fillimit të pandemisë parasheh ndarjen e pagesave në vlerë të 1 400 dollarëve për shumicën e amerikanëve. Bideni ka thënë se pagesa të tilla mund të nisin të shpërndahen më vonë gjatë këtij muaji. Republikanët besojnë se plani është shumë i kushtueshëm.



Në Maqedoninë e Veriut arrijnë 3 000 vaksina ruse

SHKUP, 7 MARS - Të dielën në Maqedoninë e Veriut kanë arritur 3 000 vaksina ruse "Sputnik V", nga rreth 200 000 sa janë porositur nga Rusia për vaksinimin e popullatës për mbrojtje nga koronavirusi.

Ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe, i cili së bashku me ambasadorin rus Sergej Bazdnikin, kanë dalë për t'i pritur vaksinat në Aeroportin Ndërkombëtar të Shkupit, tha se me këto doza do të vaksinohen personat e moshuar, të sëmurët kronikë dhe kategori të tjera, ndërsa theksoi se vakcina është e sigurt.

Ai ka bërë me dije se në ditët në vijim do t'i vazhdojnë bisedimet edhe për sigurimin e dozave të tjera, me qëllim të

vazhdimin të imunizimit të popullatës, bazuar në planin nacional për imunizim. "Vaksina është e sigurt dhe efikase. Jemi të gatshëm t'i ndihmojmë popullit maqedonas me të cilin ndajmë vlera të përbashkëta. Jemi të gatshëm që bashkëpunimin ta zgjerojmë edhe në sfera të tjera", ka deklaruar ambasadori i Rusisë në Shkup, Sergej Bazdnikin. Në Maqedoninë e Veriut deri më tani kanë arritur vetëm rreth 8 000 doza vaksinash të kompanisë amerikane "Pfizer", si donacion nga Serbia.

Me to janë vaksinuar punonjësit e Klinikës Infektive në Shkup dhe të qendrave infektive të qyteteve të tjera, si dhe punonjësit e



qendrave Covid-19.

Opozita, ndërkohë, ka kritikuar qeverinë për dështim

për sigurimin e vaksinave dhe përballjen me pandeminë që, sipas VMRO-DPMNE-së,

dëshmohet me numrin e lartë të vdekjeve dhe rritjen e rasteve me këtë virus.

Rohani: Irani është i gatshëm të marrë masa pasi të hiqen sanksionet e ShBA-së

TEHRAN, 7 MARS - Irani ka thënë se është i përgatitur për të marrë masa për zbatimin e marrëveshjes bërthamore të vitit 2015 në momentin që Shtetet e Bashkuara heqin sanksionet ndaj këtij shteti. "Irani është i gatshëm të marrë masa kompensuese, bazuar në marrëveshjen bërthamore dhe t'i përmbushë obligimet, pasi të hiqen sanksionet e paligjshme amerikane dhe pasi të braktiset politika e kërcënimeve dhe presionit", ka thënë presidenti iranian Hassan Rohani më 7 mars.

Rohani i ka bërë këto komente teksa ka pranuar ministrin e Jashtëm irlandez, Simon



Coveney, i cili po bën përpjekje për ta ruajtur marrëveshjen bërthamore.

Irlanda nuk është pjesë e marrëveshjes, mirëpo Dublini ka rol ndërmjetësues për

zbatim të marrëveshjes. Rohani ka kritikuar vendet evropiane, nënshkruese të marrëveshjes me Britaninë, Francën dhe Gjermaninë për, siç ka thënë ai, mungesën e përkushtimit për marrëveshjen.

Ai ka thënë se Irani "është pala e vetme që ka paguar çmimin e marrëveshjes".

Presidenti amerikan Joe Biden ka dhënë shenja se ka gatishmëri për ta zbatuar marrëveshjen, mirëpo insiston që Irani fillimisht t'iu kthehet përkushtimeve bërthamore.

Ish-presidenti amerikan Donald Trump është tërhequr

njëanshëm nga marrëveshja më 2018, e cila parasheh kufizimin e programit bërthamor të Iranit, në këmbim të heqjes së sanksioneve.

Administrata Trump pati thënë se marrëveshja nuk përfshin programin e raketave balistike të Iranit, dhe mbështetjen për grupet rajonale, të cilat Uashingtoni i konsideron terroriste.

Pas tërheqjes nga marrëveshja më 2018, Shtetet e Bashkuara kanë rikthyer sanksionet ndaj Iranit.

Si përgjigje, Irani ka braktisur gradualisht disa pika të marrëveshjes.

Kina: Pretendimet për gjenocid ndaj ujugurëve janë absurde

PEKIN, 7 MARS - Ministri i Jashtëm kinez, Wang Yi, ka thënë se supozimet se shteti i tij është duke kryer gjenocid kundër ujugurëve etnikë "janë absurde" dhe "gënjeshtre të

plota". Ai i ka bërë këto komente në një konferencë vjetore të dielën. Një numër kombesh, përfshirë Shtetet e Bashkuara, e kanë përdorur këtë shprehje për ta

përshkruar trajtimin që ua bën Kina ujugurëve. Këto pretendime vijnë pas të dhënave në rritje për abuzime "në kampe të përqendrimit" për ujugurët në

provincën Ksinjiang. Kina është akuzuar për kryerje të sterilizimeve të dhunshme të grave ujugure dhe për ndarje të fëmijëve nga familjet e tyre.



Dialogu me marrëveshje të neglizhuara

PRISHTINË, 7 MARS - Tre vjet më parë përfaqësuesit e kompanisë "Stone Castle" nga Rahoveci i Kosovës, e cila merret me përpunimin e rrushit dhe prodhimin e pijeve alkoolike, ishin nisur drejt kryeqytetit të Serbisë, Beogradit, për të marrë pjesë në një panair. Gjatë rrugës ata ishin njoftuar nga organizuesit se emri i Kosovës nuk bën të figurojë askund dhe as në produktet e ekspozuara në panair. Kompania "Stone Castle" kishte parapaguar pjesëmarrjen.

Teuta Kurshumlija, menaxhere e shitjes në "Stone Castle", thotë se paratë e parapaguara për pjesëmarrje në këtë panair nuk u janë kthyer nga organizatorët e panairit që ishin nga Serbia dhe Greqia, ndërkaq që dokumentet e Kosovës për produktet e kompanisë së saj ishin problem shtesë. "Një mal me probleme të tjera na i kanë krijuar edhe me dërgesën e pijeve në të njëjtin panair, me justifikime të ndryshme për probleme në dokumentacion që, në fakt, nuk ishin reale. Në një rast tjetër konkret, kishim për shkak të disa problemeve juridike me një ish-blerës që kemi pasur në Serbi. Sa herë që u jemi qasur avokatëve apo noterëve në shtetin e Serbisë, asnjëri prej tyre nuk ka pranuar ndonjë dokument në të cilin figuronte shkrimi apo logoja e Republikës së Kosovës", ka theksuar Kurshumlija.

Fakti tjetër bezdisës, sipas saj, për të gjitha kompanitë e Kosovës që eksportojnë produkte në Serbi, është pritja e gjatë që imponojnë autoritetet serbe për ndërrimin e targave të automjeteve për të qarkulluar brenda territorit të shtetit të Serbisë.

Të gjitha këto probleme, por edhe të tjera, janë rezultat i moszbatimit ose zbatimit të pjesshëm të marrëveshjeve të arritura gjatë procesit të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në Bruksel, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, i cili më 8 mars shënon 10 vjet që nga fillimi i tij, vlerëson Jeta Krasniqi nga Instituti Demokratik i Kosovës. Siç thekson ajo për "Radion Evropa e Lirë", procesi i dialogut Kosovë - Serbi kishte nisur me bisedimet për çështje teknike, ndërkaq në vitin 2012 kishte evoluuar në bisedime politike, për të kaluar më pas në bisedime për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve, me përfaqësim të nivelit të lartë politik ndërmjet kryeministrave dhe



presidentëve të të dy vendeve. Siç thotë Krasniqi, gjatë 10 vjetëve të procesit të bisedimeve Kosovë - Serbi besohet se janë arritur 31 marrëveshje, për të cilin numër, sipas saj, ka mjaft kontestime për shkak se disa prej marrëveshjeve janë negociuar sërish dhe ka pasur dokumente shtesë mbi ato marrëveshje.

Në përgjithësi, shtoi ajo, procesin e bisedimeve në Bruksel e ka mbizotëruar mungesa e transparencës dhe një pjesë e dokumenteve që kanë të bëjnë me marrëveshjet ende nuk janë publike. "Shohim që vetëm një numër i vogël i tyre (marrëveshjeve) kanë arritur zbatim të plotë dhe në përgjithësi ato nuk janë zbatuar plotësisht. Një pjesë e tyre kanë filluar të zbatohen, kanë ngecur, një pjesë e tyre nuk janë zbatuar ende. Pra, duket që nuk ka një zbatim të mirëfilltë të këtyre marrëveshjeve, duke e ditur në të njëjtën kohë që edhe vetë Bashkimi Evropian nuk është se ka krijuar mekanizma zbatues për këto marrëveshje. Duke qenë që edhe marrëveshjet e kanë atë natyrën e dykuptimisë, interpretimet e ndryshme nga Kosova dhe nga Serbia, kanë bërë që të ketë mungesë të zbatimit, duke e ditur, normalisht, se ka pasur edhe mungesë të vullnetit politik", ka theksuar Krasniqi.

Dyshtetësia problematike

Moszbatimi i disa prej marrëveshjeve të arritura në bisedimet në Bruksel ndërmjet Kosovës dhe Serbisë kanë ndikuar drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve.

Ndërrimi i targave të përhershme me targa të përkohshëm (prova) gjatë qarkullimit të automjeteve të Kosovës në territorin e Serbisë, është pjesë e marrëveshjes së lëvizjes së lirë të arritur në vitin 2011. Kjo ndodh në çdo vendkalim kufitar me Serbinë. Në anën tjetër, automjetet me targa nga Serbia qarkullojnë në Kosovë me targat e tyre origjinale. Edhe pse është thënë se Kosova do t'i mbulojë simbolet shtetërore të Serbisë në targa, kjo kurrë nuk është zbatuar. Këtë e konfirmon për "Radion Evropa e Lirë" edhe Florenti, identiteti i plotë i të cilit është i njohur për redaksinë. Ai jeton në Prishtinë, por vendlindjen e ka në Preshevë dhe shpeshherë udhëton për atje.

Procesi i ndërrimit të targave, sipas tij, merr kohë dhe shpeshherë krijon tollovi në vendkalimet kufitare me Serbinë. Targat "provë", siç thotë ai, paguhet në vlerën prej pesë eurove dhe vlejnë dy muaj. Por, për më shumë, siç rrëfen Florenti, për qytetarët shqiptarë të Kosovës të cilët kanë dyshtetësi, atë të Kosovës dhe të Serbisë, problemet lindin me patentë shofer që, në fakt, është e rregulluar me marrëveshjen e lëvizjes së lirë. Ai kishte marrë dënimin nga policia serbe prej 1 000.00 eurosh për shkak se si person me dyshtetësi, të Kosovës dhe të Serbisë, po voziste me patentë shofer të Kosovës. "Arsyeja ka qenë vetëm pse i kam dy nënshtetësi. Kam paguar diku rreth 1 000.00 euro. Arsyen e dënimit (policia) e ka shkruar sikur të isha pa leje. Kam qenë me veturë. Tabelat i

kam pasur KS. Më janë kërkuar dokumentet e Kosovës dhe ua kam dhënë. Më kanë pyetur nëse kam dokument të Preshevës dhe u kam thënë po. Në momentin që më kanë thënë 'ma jep letërnjoftimin e Serbisë', dokumentet e Kosovës m'i kanë kthyer prapa dhe e kanë shkruar 'nuk ka leje për vozitje'. Do të thotë, sikur me qenë pa patentë shofer. Pastaj kam shkruar në gjyq dhe gjykata më ka dënuar. Unë e kam pyetur edhe komandantin e policisë, një serb. Më tha 'po të mos e kishe edhe nënshtetësinë e Serbisë, mund të vozitje, por ti që i ke dy nënshtetësi, nuk ke të drejtë. Është shumë e çuditshme', ka thënë Florenti.

Në korrik të vitit 2011 Kosova dhe Serbia ishin marrë vesh në Bruksel për pranimin e ndërsjellë të diplomave universitare të të dyja vendeve. Në prill të vitit 2016 palët kishin rikonfirmuar se do ta zbatojnë marrëveshjen për pranimin reciprok të diplomave profesionale dhe akademike. Por, Kosova kishte bërë një hap më përpara në vitin 2015 duke sjellë dekretin për procedurat dhe kriteret për lëshimin e certifikatave për qytetarët e Kosovës të cilët kanë mbaruar Universitetin e Mitrovicës së Veriut, i cili punon sipas sistemit të Serbisë.

Në vitin 2016 në Kosovë filloi procesi i njohjes së këtyre diplomave dhe kërkesat për verifikim ishin dorëzuar nga 1 735 të diplomuar, prej të cilëve mbi 1 650 janë aprovuar. Fismir Jahiu, shqiptar nga Bujanoci, një komunë në jug të Serbisë, i cili ka diplomuar në studimet e nivelit master për Ekonomi në

Universitetin e Prishtinës, megjithatë nuk i është pranuar diploma nga autoritetet serbe. Por, kjo situatë nuk është edhe me të rinjtë serbë në Kosovë, të cilët kanë përfunduar shkollimin e lartë në Universitetin e Mitrovicës së Veriut, që punon sipas sistemit të Serbisë, si dhe në universitetet në Serbi.

Predrag Milkoviq nga Lipjani, në afërsi të Prishtinës, ka diplomuar në Fakultetin Juridik në kuadër të Universitetit në Mitrovicën e Veriut, i cili funksionon sipas sistemit arsimor të Serbisë.

Në vitin 2018, për shkak të karrierës profesionale të mëtejshme, ai e kishte verifikuar diplomën në Ministrinë e Arsimit të Qeverisë së Kosovës. Jeta Krasniqi nga Instituti Demokratik i Kosovës konsideron se është e qartë që Kosova ka zbatuar një pjesë më të madhe të marrëveshjeve në krahasim me Serbinë, autoritetet e së cilës e thonë të kundërtën.

Përfaqësuesi i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun, Miroslav Lajçak, i cili e vizitoi Kosovën dhe Serbinë ditë më parë, ka deklaruar se procesi i dialogut mund të përmbyllet shpejt nëse palët kanë përkushtim dhe vullnet për një gjë të tillë, brenda mandatit të qeverisë së re. Qëllimi i vazhdimit të dialogut është arritja e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe ligjërishme e obligueshme, që synim final ka normalizimin e raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe zgjidhjen e të gjitha çështjeve të hapura ndërmjet dy vendeve.



SHTOHEN DYSHIMET PËR MANIPULIM TË VOTAVE NË ZGJEDHJET
E PARAKOHSHME PARLAMENTARE TË 14 SHKURTIT

Kërkohet rinumërimi i votave

Disa kandidatë për deputetë të subjekteve të ndryshme politike kanë kërkuar rinumërim të tërësishëm të votave. Kërkesa e tyre ka ardhur pas publikimit të një videoincizimi, në të cilin pretendohet se burri i kryediplomates Meliza Haradinaj-Stublla ka blerë vota në bashkëpunim me disa komisionarë në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR). Demokracia në Veprim (DnV) i ka bërë thirrje Prokurorit të Shtetit që t'i nisë menjëherë hetimet rreth dyshimeve për falsifikim të votave brenda QNR-së. Ndërsa Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka komunikuar me prokurorinë, duke u shprehur i gatshëm për bashkëpunim rreth zbardhjes së rasteve për manipulim të votave

**EPOKA
ERE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 7 MARS - Publikimi i një videoincizimi, në të cilin tre persona dyshohet se flasin për falsifikimin e votave të kandidatëve në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), ka nxitur reagime të shumta. Pas publikimit të këtij videoincizimi disa kandidatë për deputetë të partive të ndryshme kanë ngritur dyshime për manipulim të votave të tyre nga komisionarët. Këta kandidatë, shoqëria civile dhe njohës të rrethanave politike kanë kërkuar rinumërim të votave dhe kanë ftuar prokurorinë ta hetojë këtë

rast.

Ndërsa Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është shprehur i gatshëm të bashkëpunojë me prokurorinë për zbardhjen e rastit. Kandidatja për deputete e LDK-së, Lirije Kajtazi, ka shprehur dyshime se edhe rezultati i saj është përmbysur në minutat e fundit në QNR. "Me këtë model u përmbys edhe rezultati im në minutat e fundit në qendrën për fabrikimin e rezultateve! Të nderuar qytetarë, unë po vazhdoj betejën time, jo për një mandat në Kuvend, por angazhimin tim të përjetshëm në luftën për drejtësi dhe demokraci", ka shkruar Kajtazi në profilin e vet në "Facebook".

Të njëjtat dyshime i ka shprehur edhe kandidati tjetër i LDK-së për deputet, Faton Bislimi. "Më 4 mars unë kam folur për inxhinjering elektoral dhe ai u faktua me skandalin e blerjes së votave në QNR për kandidaten e AAK-së. Ky skandal kompromiton skajshmërisht procesin zgjedhor. Ky model i vjedhjes së vullnetit të sovranit ka prekur edhe shumë kandidatë të tjerë. Të paktën që do të duhej ta bënte sot PZAP-i është të dërgonte në rinumërim komplet votat me kusht dhe ato të diasporës (të cilat ekskluzivisht janë numëruar në QNR) dhe secilën kuti tjetër ku ka një fije dyshimi për

manipulim. Përndryshe, demokracia jonë fragjile po fundoset. Burgu është pak në krahasim me fundosjen e demokracisë", ka shkruar Bislimi.

Duke i parë pretendimet e kolegëve të saj, ka reaguar edhe anëtarja e kryesisë e LDK-së, Hykmete Bajrami, e cila ka thënë se KQZ-ja duhet të marrë vendim për rinumërim të secilës kuti të votimit nga zgjedhjet e 14 shkurtit. "KQZ-ja të marrë vendim për rinumërim të secilës kuti nën vëzhgim të kamerave, në transmetim live në televizionet nacionale. Nëse nuk bëhet për kandidatët, duhet të bëhet për qytetarët", ka shkruar Bajrami në llogarinë e vet në "Facebook", e cila, sipas rezultateve përfundimtare të KQZ-së, është bërë deputete. Edhe AKR-ja, e cila ka garuar në listën e LDK-së, ka shprehur dyshime për manipulim të votave. Kandidati për deputet i kësaj partie, Jetlir Zyberaj, ka thënë se ka dëshmi për manipulim të votave. "Kjo është vetëm një nga dëshmitë e prezantuara në PZAP për vjedhjen e votave nga

komisionarët e kriminalizuar. Unë kam informacione që do t'i adresoj edhe në prokurori për vjedhjen e organizuar të votave. Rinumërimi i plotë i votave është absolutisht i nevojshëm për të siguruar procesin e degraduar zgjedhor. Informacionet e sakta thonë se ka ekzistuar plan i organizuar i vjedhjes së votave të presidentit Pacolli dhe votave të mia si kandidat. Rinumërimi i plotë do t'i nxirrte në shesh kriminelët dhe urdhërdhënësit e tyre", ka shkruar Zyberaj në profilin e vet në "Facebook". Analisti politik Ilir Mirena ka thënë se dyshimet e ngritura nga partitë politike mund të qartësohen vetëm me një rinumërim të tërësishëm të votave. "Behgjet Pacolli i ka marrë afër 12 mijë vota në listën LDK-AKR. I vetmi nga AKR-ja. Marrë parasysh se kjo parti, sado e vogël, e ka një elektorat të caktuar në rajonin e Prishtinës, atëherë mund të dyshohet që edhe këtyre u janë vjedhur votat nga komisionarët e LDK-së. Nuk ka mundësi që 12 000 votues të Behgjetit të mos e kenë votuar vëllanë e tij,

apo këshilltarin e tij me të afërt, Jetlir Zyberaj që, po ashtu, ishin në listën për deputetë të AKR-së. Një rinumërim s'do t'ju bënte keq", ka vlerësuar Mirena.

Të hetohen dyshimet për falsifikim të votave të kandidatëve

Koalicioni i organizatave për vëzhgimin e zgjedhjeve në Kosovë, Demokracia në Veprim (DnV), i ka bërë thirrje Prokurorit të Shtetit që t'i nisë menjëherë hetimet rreth dyshimeve për falsifikim të votave brenda Qendrës për Numërim dhe Rezultate (QNR) për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 14 shkurtit. Sipas DnV-së, prokuroria në bashkëpunim me Panelin

Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe Sekretariatin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duhet të veprojnë për gjetjen dhe arrestimin e personave që dyshohen se kanë falsifikuar rezultatin e votimeve. "Audio dhe videoincizimi tregojnë se si numëruesi i votave jep çmimin për ndryshimin e votave brenda kandidatëve të listës së një subjekti politik. I dyshuari, po ashtu, tregon se sa para kishte marrë ai dhe dy persona të tjerë brenda QNR-së për t'i ndryshuar votat e një kandidateje për deputete të Kuvendit të Kosovës, që ajo të bëhej pjesë e legjislaturës së VIII. Demokracia në Veprim i bën thirrje Prokurorit të Shtetit që me urgjencë të fillojnë

hetimet dhe të merren masat adekuate që të mos lejohet deformimi i vullnetit të votuesve nga dyshimet për falsifikimin e votave brenda QNR-së", është thënë në reagimin e DnV-së.

Ky koalicion i organizatave ka ftuar të gjithë kandidatët për deputetë të cilët mund të kenë dyshime për vjedhje të votave, të bashkëpunojnë me prokurorinë. "Prokuroria në bashkëpunim me Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe Sekretariatin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duhet të veprojnë për gjetjen dhe arrestimin e personave që dyshohen se kanë falsifikuar rezultatin e votimeve. DnV u bën thirrje të gjithë

kandidatëve për deputetë të cilët mund të kenë dyshime për vjedhje të votave apo falsifikim të rezultatit, pos ankesave në PZAP, të bashkëpunojnë me Prokurorinë e Shtetit për zbulimin e veprave që devijojnë vullnetin e qytetarëve të Kosovës", është thënë në reagim.

Kurse Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka bërë me dije se pas videoincizimit të publikuar në media, ku bëhet fjalë për blerje të votave, ka kontaktuar Prokurorinë e Shtetit.

Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se ky institucion është i gatshëm për të bashkëpunuar me prokurorin për zbardhjen e rastit. "Menjëherë pas transmetimit

në media të lajmit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka komunikuar me Prokurorinë e Shtetit për t'i ofruar të gjitha informacionet dhe materialet e nevojshme për hetimin dhe zbardhjen e plotë të rastit. Ju lutem që për detaje të tjera t'i drejtoheni Prokurorisë së Shtetit", ka thënë Elezi.

Sipas rezultatit përfundimtar të KQZ-së, Lëvizja Vetëvendosje ka shënuar fitore bindëse, duke siguruar 58 ulëse në legjislaturën e re. Pas saj renditet PDK-ja me 19 ulëse, LDK-ja me 15 dhe AAK-ja me 8 ulëse në Kuvend. Në afatin 24-orësh për ankesa, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar, në PZAP janë dërguar 208 ankesa. PZAP-i lidhur me këto apele do të vendosë brenda afatit ligjor prej 72 orëve.

PZAP-i miraton pjesërisht ankesën e një kandidateje boshnjake



PRISHTINË, 7 MARS - Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) e ka konsideruar pjesërisht të bazuar ankesën e Zikreta Alitit, kandidate për deputete nga komuniteti boshnjak, Partia e Re Demokratike (NDS). PZAP ka urdhëruar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që t'i numërojë votat e kandidatëve për deputetë nga radhët e

NDS-së në vendvotimin 2009A/05D në Komunën e Prizrenit.

Partitë nga komunitetet joserbe në Kosovë kanë dorëzuar ankesë në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, duke kërkuar që të anulohen votat e komunitetit serb për partitë boshnjake dhe rome në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të

14 shkurtit.

Dy subjektet politike boshnjake, Unioni Socialdemokrat (SDU) dhe Partia e Re Demokratike (NDS), kanë akuzuar themeluesen e Komunitetit të Bashkuar, Adrijana Hoxhiq, se votat nga komunat me shumicë serbe i ka siguruar përmes Listës Serbe.

Këtë të fundit e kanë akuzuar

se po planifikonte që "përmes trupit të saj votues të ushtrijë ndikim dhe të vë nën kontroll disa nga komunitetet joshumicë në Kosovë".

Por, Hoxhiq, ndonëse ka pranuar se ka marrë vota nga mjediset me shumicë serbe, ka hedhur poshtë akuzat se ato i janë siguruar nga Lista Serbe. Sipas Kushtetutës së Kosovës, komuniteti boshnjak i ka të

garantuara tri ulëse në Kuvendin e Kosovës.

Komuniteti turk ka të garantuara dy ulëse, ndërkaq për përfaqësuesit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas janë të garantuara nga një ulëse si dhe një ulëse shtesë për njërin nga këto komunitete që fiton më së shumti vota.

Një ulëse e garantuar i takon edhe komunitetit goran.

Ndërron jetë profesor Zejnullah Gruda



PRISHTINË, 7 MARS (ER) - Ka ndërruar jetë profesori i mirënjohur i së Drejtës Ndërkombëtare, Zejnullah Gruda. Për vdekjen e tij kanë shprehur ngushëllime përfaqësues të institucioneve, liderë të partive politike, profesorë dhe shoqëria civile. Ushtruesja e detyrës e presidentit të vendit, Vjosa Osmani, ka ngushëlluar familjen Gruda me rastin e vdekjes të anëtarit të tyre, profesorit Zejnullah Gruda. "Sot iku edukuesi i shumë brezave, prof. dr. Zejnullah Gruda, por shembulli i tij dhe vepra që la pas do të jetojnë përgjithmonë. Ngushëllime familjes Gruda si dhe të gjithë bashkëpunëtorëve e brezave të shumtë të studentëve që patën nderin ta kenë profesor", ka shkruar Osmani

në llogarinë e vet në "Facebook".

Për vdekjen e tij ka shkruar edhe kryetari i Pejës, Gazmend Muhaxheri. Në një shkrim në llogarinë e vet në "Facebook", ai ka thënë se Gruda ishte një ndër profesorët pejan më të shquar i cili ka dhënë kontribut të madh për botën akademike. "Prehu në paqe profesor i dashur. Ngushëllimet i përcjell edhe te të afërmit e tjerë, miqtë, kolegët dhe studentët e profesorit të ndjerë. I paharruar qoftë kujtimi për profesorin Gruda!", ka shkruar Muhaxheri në "Facebook".

Ngushëllime familjes Gruda i ka shprehur edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj. Ai ka thënë se Zejnullah Gruda i ka shërbyer atdheut

me devotshmëri duke edukuar breza të tërë. "Do të mbahet mend për mprehtësinë e mendjes, urtësinë dhe guximin intelektual. Ndajmë dhembjen me familjen Gruda, kolegët e studentët e tij dhe të gjithë ata që e njohën. Pusho në paqe profesor!", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Zejnullah Gruda gjatë gjithë karrierës së tij është marrë me botime dhe publikime të shumta. Ka qenë aktiv me opinionet e tij, sidomos sa i përket çështjeve të kufijve. Po ashtu, prej shumë vitesh ka qenë profesor i rregull universitar. Gruda ka qenë anëtar i Komisionit për Demarkacionin e Kufirit të Kosovës me Malin e Zi.

Nëntë të vdekur dhe 548 raste të reja me Covid në Kosovë

Autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë regjistruar të dielën 548 raste të reja me Covid-19 pas testimit të 4 193 mostrave në institucionet publike dhe private. Sipas Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike në Kosovë (IKShPK), më 7 mars janë regjistruar nëntë viktima



AMBULANCA PËR
CORONAVIRUS

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

Prishtinë, 7 mars - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë janë testuar gjithsej 4 193 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultojnë 548 raste pozitive.

Brenda 24 orëve janë raportuar nëntë raste të të vdekurve si pasojë e këtij virusi. Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Gjakovë dy raste (80, 76 vjeç), Mitrovicë dy raste (84, 73 vjeç), Prishtinë dy raste (67, 70 vjeç), Ferizaj një rast (72 vjeç), Istog një rast (69 vjeç), Viti një rast (58 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 73 048 raste nga 329 900 persona të dyshimtë me këtë

virus dhe 1 649 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 301 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 61 986 raste, kurse numri i rasteve aktive është 9 413. Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 250 raste, Pejë 34 raste, Mitrovicë 31 raste, Gjakovë 29 raste, Gjilan 22 raste, Lipjan 20 raste, Obiliq

17 raste, Suharekë 17 raste, Vushtrri 16 raste, Ferizaj 15 raste, Fushë-Kosovë 12 raste, Kamenicë 11 raste, Podujevë 11 raste, Deçan 8 raste, Klinë 8 raste, Prizren 8 raste, Rahovec 8 raste, Skenderaj 8 raste, Kaçanik 5 raste, Viti 5 raste, Novobërdë 4 raste, Istog 3 raste, Drenas 2 raste, Shtime 2 raste dhe me nga 1 rast komunat Graçanicë, Malishevë.

Kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, ka bërë me dije se këtë muaj pritet të arrijë kontingjenti i parë prej 33 mijë dozave të vaksinës COVAX, ku Republika e Kosovës do të përfitojë 100 800 doza të vaksinës kundër Covid-19. Edhe komiteti për vlerësimin dhe koordinimin e situatës epidemiologjike kundër Covid-19 në takimin e fundit

ka kërkuar mirëmbajtjen e masave në fuqi kundër Covid-19 dhe respektimin e tyre të plotë. Në takimin e këtij komiteti të drejtuar nga ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj, nga institucionet monitoruese dhe mbikëqyrëse u kërkua që ta rritin angazhimin për respektimin rigoroz të masave në fuqi.

Shënohet 7 Marsi, Dita e Mësuesit në Kosovë

SBASHK-u, institucioneve: Arsimi të jetë prioritet



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK) ka uruar të punësuarit në arsim për 7 Marsin, Ditën e Mësuesit, duke theksuar se do të vazhdojë të jetë zëri i tyre për realizimin e kërkesave legjitime. SBASHK-u u ka bërë thirrje partive politike, atyre që do të vijnë në pushtet, që t'i mbajnë premtimet e tyre që arsimi të jetë prioritet

**EPOKA
ERE****Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 7 MARS - Mësues, nxënës, profesorë dhe edukatorë gjithandej në Kosovë, kanë shënuar 7 Marsin, Ditën e Mësuesit. Ndërkaq përfaqësues të institucioneve vendore dhe të partive politike kanë uruar mësimit për këtë ditë. Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK) ka uruar të punësuarit në arsim duke theksuar se do të vazhdojë të jetë zëri i tyre për realizimin e kërkesave legjitime. Të premtën dhe të shtunën SBASHK-u ka organizuar nëpër komunat e Kosovës ceremoni festive me kolegët e pensionuar nga marsi i vitit të kaluar e këndej që kanë punuar me vite e dekada në çerdhe, në arsimin parauniversitar apo universitet, duke u ndarë mirënjohje për punën dhe përkushtimin e tyre e duke kujtuar me fjalë rasti kontributin e lartë të pishtarëve të dijes që nga shkolla e parë

shqipe e deri në ditët e sotme. "Në këto takime festive është folur edhe për sfidat dhe angazhimin në shërbim të arsimit ndër vite e dekada dhe me krenari është vlerësuar se SBASHK-u ka arritur t'i realizojë në tërësi kërkesat e anëtarësisë dhe kështu do të vazhdohet edhe sot e gjithmonë. SBASHK-u, duke i uruar gjithë të punësuarit në arsim për ditën e madhe të mësuesit dhe shkollës shqipe, kujton subjektet politike dhe liderët se kishin deklaruar vazhdimisht se arsimin e kanë prioritet, por me të ardhur në pushtet nuk e kanë dëshmuar këtë", është thënë në komunikatën e SBASHK-ut. Ministri në detyrë i Arsimit dhe Shkencës, Ramë Likaj, me rastin e 7 Marsit, Ditës së Mësuesit, ka thënë se mësuesit e mirë janë udhërrëfyes dhe frymëzues në rrugën e ngritjes individuale dhe faktorë kyç për emancipimin shoqëror. Ai përmes një shkrimi publikuar në logarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se e

ardhmja nis dhe vulozet në bankat e shkollës. "Kjo datë na përkujton 7 marsin e 1887-s, kur u hap në Korçë mësonjëtorja e parë shqipe nën drejtimin e Pandeli Sotirit. Sot nuk mund të lëmë pa e theksuar kontributin e punonjësve të arsimit që edhe në këto rrethana të jashtëzakonshme mbajten shkollat hapur dhe arsimin e trajtuan me prioritet. Janë ata që ndër vite kontribuuan për të mbajtur gjallë arsimin shqip dhe shumë prej tyre nuk e kursyen as jetën për lirinë e vendit. Mësuesit e mirë janë udhërrëfyes dhe frymëzues në rrugën e ngritjes individuale dhe faktor kyç për emancipim shoqëror. E ardhmja nis dhe vulozet në bankat e shkollës", ka thënë Likaj. Kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, ka uruar mësimit për 7 marsin, duke theksuar se ata meritojnë mirënjohje dhe falënderim për gjithë kontributin e tyre ndër vite, në edukimin dhe arsimimin e

gjeneratave të tëra, në kohë dhe rrethana jo gjithnjë të favorshme gjatë historisë tonë. "Respekt i veçantë për mësimit që mbajten gjallë entuziazmin dhe idealin për liri e pavarësi gjatë viteve '90. Mirënjohje për mësimit në gjithë Kosovën për punën e jashtëzakonshme që kanë bërë gjatë këtij viti sfidues, kur vendi ynë, sikurse e gjithë bota, po vazhdon të përballet me pandeminë Covid-19. Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës do të angazhohet dhe ta vazhdojë përkrahjen për ngritjen e cilësisë në të gjitha nivelet e arsimit. Të gjithë mësimit u përcjell urimet më të përzemërta dhe konsideratën time më të lartë për punën dhe kontributin e çmuar!", ka thënë Hoti në mesazhin e tij. Me rastin e 7 Marsit, Ditës së Mësuesit, lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë se personaliteti mësimit mbart drejtpërdrejt fuqinë që i jep virtyti publik i shoqërisë sonë. "Sot është dita e mësuesve dhe mësuesve tanë. Personaliteti mësimit mbart drejtpërdrejt fuqinë që i jep virtyti publik i shoqërisë sonë. Mësuesi vjen menjëherë pas prindit. Sapo fëmija del prej ngrohtësisë së nënës, babait dhe

vatrës, ka përpara vetes dhe bashkëmoshatarëve të vet një autoritet të ri të cilin e dashuron jo thjesht prej ndjenjës, por prej dijes. Në sytë e shkollarit mësuesi është përfaqësuesi i një jete që çelet përpara", ka shkruar Kurti në logarinë e vet në "Facebook". Edhe kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka thënë se Republika e Kosovës, liria dhe pavarësia e saj, nuk do të ishin të mundura pa mësuesit dhe rolin e tyre të jashtëzakonshëm përgjatë historisë. "Misioni i tyre i hershëm për zhdukjen e analfabetizmit dhe më pas organizimi paralel i mësimit shqip në kohën e okupimit serb u bë platforma kombëtare që e ruajti kulturën e popullit tonë nga zhdukja. Mësuesit janë heronj të ditëve tona. Sot patriotizmi më i madh që mund ta shprehim është edukimi i gjeneratave dhe ndërtimi i një baze të fortë kombëtare e shoqërore përmes arsimit të mirëfilltë. Jam krenar që një pjesë të madhe të karrierës sime ia kam kushtuar avancimit të arsimit në Kosovë, krijimit të qasjes në shkollim për secilin qytetar të Kosovës dhe lehtësimin e barrierave ekonomike dhe gjeografike për mësimit, nxënësit dhe studentët", ka thënë Hoxhaj.



Ekspertët e ekonomisë: CEFTA duhet të ketë vëmendje për mostrajtim të barabartë

Ekspertë të ekonomisë, përfaqësues të bizneseve vendore dhe ndërkombëtare, Safet Gërzhaliu, Burim Piraj dhe Emrush Ujkani, kanë kërkuar që të rinegociohen Marrëveshja e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë (CEFTA) dhe Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA), pasi prodhuesit e Kosovës vazhdojnë të pengohen nga Serbia dhe Bosnje Hercegovina

të Komitetit për Energji. “Ankesa kemi pasur së fundmi kryesisht me fillimin e zbatimit të tarifave të reja të energjisë që dalin si rezultat i zbatimit të obligimeve nga Traktati i Komunitetit për Energji, të cilat nga bizneset konsiderohen të larta dhe të dëmshme për sektorin privat”, ka deklaruar Ujkani.

Ankesa të njëjta sa i përket vënies së barrierave nga Serbia dhe Bosnje Hercegovina dhe për mostrajtim të barabartë si dhe kufizime të lirisë së lëvizjes ka edhe prodhuesi vendor, Burim Piraj. Ai ka thënë se CEFTA dhe MSA-ja patjetër duhet të rishikohen meqenëse, sipas tij, ka shumë hapësira për përmirësim. “Së pari Kosovës në CEFTA dhe MSA nuk i bëhet trajtim i barabartë me vendet e tjera. Në këto dy traktate ka aq shumë hapësirë për përmirësime të cilat duhet patjetër të rishikohen”, ka thënë Piraj, i cili ka theksuar se të dyja këto traktate e lënë Kosovën në vend konsumues. “Të dy këto traktate e fusin Kosovën brenda hapësirës së tyre ekonomike dhe e shndërrojnë në vend konsumues të prodhimeve të vendeve të BE-së dhe CEFTA-s. Nga ana tjetër Kosovës i vendosin barriera jotarifore që produktet me rëndësi

strategjike për zhvillim, siç janë mishi, qumështi dhe vezët, të mos mund të eksportohen nga Kosova drejt tyre. Dihet mirë se katalizatorë kryesorë të zhvillimit të bujqësisë në një vend janë mishi, qumështi dhe vezët. Për këtë arsye, Kosovës i ka ngelur djerrinë fusha, sepse importon miliona tona mish dhe qumësht të subvencionuar nga Evropa dhe rajoni”, u shpreh ai.

Po ashtu, Piraj ka thënë se ky trajtim është shkas i ngecjes së investimeve të huaja.

Për këtë çështje ka folur edhe eksperti i ekonomisë, Safet Gërzhaliu, i cili ka thënë për gazetën “Epoka e re” se institucionet e Kosovës duhet të këndellen në këtë drejtim dhe ta kenë prioritet agjendën ekonomike. “Në një vend ku dominon agjenda politike, mbesin shumë probleme të hapura. Në këtë drejtim, brenda një viti kalendarik, përveç pandemisë Covid-19, kemi pasur pandemi politike”, është shprehur ai.

Gërzhaliu ka thënë se është koha që Kosova të përfaqësohet denjësisht në CEFTA e kudo tjetër. “Vetë fakti që në vitin e fundit apo në periudhën kohore 2019-2020-2021 Kosova është përfaqësuar me tre koordinatore të ndryshëm të

cilët është dashur t’i adresojnë problemet në sekretariatit e CEFTA-s, qoftë edhe në MCC. Tani është koha kur Kosova duhet të përfaqësohet denjësisht në këto iniciativa dhe të ketë kontinuitet. Besoj se këto probleme që bëhen për prodhimet Made in Kosova, është koha kur duhet të alarmohet CEFTA dhe duhet të ketë rinegocim në mënyrë që të argumentohet pabarazia”, u shpreh ai.

Gërzhaliu ka thënë se patjetër duhet të gjendet një alternativë që të ndalet diskriminimi ndaj prodhuesve të Kosovës. “E dini që në Sofje janë shtuar dy dokumente shumë të rëndësishme në kuadër të procesit të Berlinit në vitin 2020. Ato kanë të bëjnë me tregun rajonal dhe agjendën Gree. Shtrohet pyetja si mund të jemi pjesë e këtyre iniciativa kur ne nuk jemi të barabartë, në pamundësi të lëvizjes qoftë në Bosnjë apo në Serbi. Kur krejt kësaj i shtohet edhe fakti që janë katër parimet bazë që duhet të plotësohen: liria e lëvizjes së mallrave, e shërbimeve, e kapitalit dhe e njerëzve. Këto për Kosovën janë vetëm në letër, sepse nuk zbatohen. Tani duhet të gjendet një alternativë tjetër në interes të bizneseve dhe qytetarëve”, ka

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 7 MARS - Ekspertë të ekonomisë dhe përfaqësues të bizneseve vendore dhe ndërkombëtare kanë thënë për gazetën “Epoka e re” se duhet t’i tregohet CEFTA-s se po bëhet trajtim i pabarabartë në mes të prodhuesve të Kosovës për shkak të barrierave të vëna nga Serbia dhe Bosnje Hercegovina ndaj bizneseve të Kosovës. Për këtë shkak, ata kanë kërkuar vëmendje nga CEFTA lidhur me këtë rast. Ata kanë theksuar se duhet të rishikohet edhe MSA-ja për kufizimin e lëvizjes së lirë. Drejtori ekzekutiv i Këshillit të Investitorëve Evropianë, Emrush Ujkani, ka thënë për gazetën “Epoka e re” se vazhdimisht marrin ankesa për mostrajtim të barabartë nga

vendet e CEFTA-s dhe MSA-së. Sipas tij, ky mostrajtim i barabartë ndikon edhe në mossuksesin e Kosovës në tërheqjen e investimeve të huaja. “Bizneset ankohen për barriera të njëanshme në raport me shtetin serb dhe moszbatim të CEFTA-s dhe MSA-së. Institucionet e vendit duhet t’i qasen me kujdes rishikimit apo edhe analizimit të marrëveshjeve, qoftë atyre të karakterit rajonal dhe atyre që Kosova i ka nënshkruar veçanërisht me Serbinë në kuadër të procesit të Brukselit. Kosova duhet të ndërmerret edhe një numër të caktuar reformash, kryesisht duke përmirësuar infrastrukturën ligjore dhe fuqizimin e zbatimit të ligjit”, ka deklaruar Ujkani. Ai në këtë drejtim vuri theksin edhe tek obligimet shtesë që janë vënë në kuadër të Traktatit

thënë Gërxhaliu.

Kosova u bë anëtare fuqplotë e CEFTA-s në korrik të vitit 2007, tetë muaj pas nënshkrimit të marrëveshjes për anëtarësim, ndërkaq marrëveshja për anëtarësim u nënshkrua nga UNMIK-u në emër të Kosovës.

Marrëveshja për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore (CEFTA) është krijuar me qëllim të eliminimit të pengesave për tregtinë reciproke mes shteteve anëtare, krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin dhe diversifikimin e tregtisë, si dhe nxitjen e bashkëpunimit tregtar dhe ekonomik.

Ndërkaq, në vitin 2008 institucionet e Kosovës ndëruan edhe vulat doganore, nga Doganat e UNMIK-ut në Doganat e Kosovës, gjë që ky akt u bë shkas për Serbinë dhe Bosnjën për ta bllokuar eksportin e mallrave të Kosovës në këto dy shtete apo për ta përdorur territorin e tyre për mallrat transit.

Në preambulën e marrëveshjes së CEFTA-s, neni 1 thotë: "Palët do të krijojnë një zonë të tregtisë së lirë në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje dhe në përputhje me rregullat dhe procedurat përkatëse të OBT-së".

Mirëpo edhe përkundër pajtimit për tregti të lirë në mes të Kosovës dhe vendeve anëtare të kësaj marrëveshjeje, bizneset nga Kosova vazhdimisht janë përballur e vazhdojnë të përballen me barriera nga Serbia dhe Mali i Zi. Kurse objektivat e kësaj marrëveshjeje janë: a). Të konsolidojë në një marrëveshje të vetme nivelin ekzistues të liberalizimit të tregtisë të arritur nëpërmjet rrjetit të marrëveshjeve bilaterale të tregtisë së lirë, tashmë të lidhura ndërmjet palëve; b). T'i përmirësojë më tej kushtet për nxitjen e investimeve, duke përfshirë investimet e huaja direkte; c). Ta zgjerojë tregtinë e mallrave, shërbimeve dhe t'i forcojë investimet me anë të rregullave të drejta, të qarta, të qëndrueshme dhe të parashikueshme; d). T'i eliminojë barrierat dhe deformimet e tregtisë dhe ta lehtësojë lëvizjen e mallrave në transit dhe lëvizjen ndërkufitare të mallrave dhe shërbimeve ndërmjet territoreve të palëve.

Marrëveshje tjetër e cila është nënshkruar nga Kosova dhe Bashkimi Evropian, e që për qëllim ka tregtinë e lirë, e që nuk po zbatohet dhe prodhuesit nga Kosova që vazhdojnë të kenë barriera nga Serbia dhe Bosnje Hercegovina, është edhe Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) e nënshkruar në tetor 2015, kurse hyri në fuqi më 1 prill të vitit 2016.

GAP-i: Vendimet për themelimin e zonave ekonomike kanë qenë të motivuara politikisht

PRISHTINË, 7 MARS (ER) - Instituti GAP ka publikuar raportin mbi ligjin e ri për Zonat Ekonomike. Projektligji synon t'i rregullojë aspektet kryesore të zonave ekonomike, sikurse që është kompetenca për themelimin e tyre, mënyra e administrimit, vendndodhja e zonave, afati kohor për shfrytëzim, si dhe format për promovimin e zonave ekonomike.

Përkundër se baza ligjore për

themelimin e zonave ekonomike ekziston që nga viti 2009, përgjatë gjithë kësaj periudhe ka pasur paqartësi ligjore dhe konflikt kompetencash për themelimin e zonave ekonomike.

Vendimet qeveritare për themelimin e zonave ekonomike më shumë kanë qenë të motivuara politikisht sesa të bazuara në studime dhe analizë të të mirave (cost-benefit) të

ekzistimit të tyre.

Po ashtu, qeveria ka shfrytëzuar zonat ekonomike edhe si mjet për shpronësime të pronave private për përfitime të grupeve të caktuara. Punimet për finalizimin e infrastrukturës në zona ekonomike kanë zgjatur për shumë vite dhe shumë biznese kanë prishur kontratat për t'u vendosur në këto zona për shkak të zvarritjes së punimeve.

Edhe pse mbi 76 biznese janë

vendosur në këto zona dhe zonat ekonomike zënë së paku 422.5 hektarë hapësirë, nuk ka një analizë të hollësishme të përfitimeve ekonomike, rritjes së investimeve dhe punësimit.

Ndryshimet e propozuara në Ligjin për zonat ekonomike, përveç qartësimin të procedurave ligjore, prapëseprapë nuk ofrojnë iniciativë të mjaftueshme për ndërmarrjet që vendosen në zonat ekonomike.



Tatimet e produkteve përbëjnë pjesën më të madhe të të hyrave qeveritare

PRISHTINË, 7 MARS (ER) - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar llogaritë qeveritare të Kosovës për tremujor. Ky botim paraqet pasqyrën e të hyrave dhe shpenzimeve qeveritare brenda tremujorit të katërt (TM4) 2020. Sipas ASK-së, shuma e të hyrave të Qeverisë së Përgjithshme në TM4 2020 ishte 703.2 milionë euro. Pjesën më të madhe të të hyrave e përbëjnë tatimet në produkte, ndërsa pjesa e mbetur është shpërndarë në kategori të tjera të të hyrave. "Shuma e shpenzimeve e qeverisë së përgjithshme në TM4 2020 ishte 817.1 milionë euro", është thënë në raport. Sipas këtij raporti, pjesën më të madhe të shpenzimeve e përbëjnë kontributet sociale dhe



përfitimet (21.3 për qind), kompensimi i punëtorëve (20.9 për qind), formimi i kapitalit

bruto (16.6 për qind) dhe konsumi i ndërmjetëm (10.8 për qind). Pjesa e mbetur e

shpenzimeve është shpërndarë në kategori të tjera të shpenzimeve.

Komuna e Mitrovicës nënshkruan marrëveshje për fuqizimin e të rinjve

MITROVICË, 7 MARS (ER) - Nën kryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, së bashku me drejtoreshën e Administratës së Përgjithshme, Valmira Sylejmani, kanë pritur në takim përfaqësuesin e organizatës Youth Initiative for Human Rights (YIHR KS), Vilson Haxholli. Qëllimi i këtij takimi ishte nënshkrimi i marrëveshjes

së bashkëpunimit për fuqizimin e të rinjve të cilët kërkojnë drejtësi dhe të bëhen pjesëmarrës aktivë në sektorin e drejtësisë në Kosovë si dhe të rritë qasjen në drejtësi në nivelin komunal. Përmes kësaj marrëveshje Komuna e Mitrovicës u mundëson tre studentëve të mbajnë punë praktike tremujore në institucionin e saj në kuadër

të projektit “Rritja e qasjes në drejtësi në nivelin komunal”. Me këtë rast, nënkryetari Mujka së bashku me Haxholli u zotuan për bashkëpunim të ngushtë dhe në mënyrë konstruktive për të ndërmarrë çdo veprim të dyanshmëm për realizimin e projekteve që ndikojnë në rritjen e qasjes në drejtësi në nivelin komunal.



Promovohet monografia “Shkollat dhe arsimiti në Kërpimëh me rrethinë përgjatë kohërave”

PODUJEVË, 7 MARS (ER) - Përndër të 7 Marsit, Ditës së Mësuesit, në Shkollën Filllore e Mesme e Ulët “Hamit Sejdiu” në Kërpimëh u përurua monografia “Shkollat dhe arsimiti në Kërpimëh me rrethinë përgjatë kohërave”, nga autori tashmë i ndjerë Milazim Kadriu.

Në përurimin e monografisë morën pjesë ish-presidenti i Republikës së Kosovës, Fatmir Sejdiu, nënkryetarja e Komunës së Podujevës, Marigona Lahu, drejtori i Drejtorisë së Arsimit, Avni Fetahu, familjarë të autorit të monografisë, ish-deputetë, veteranë të arsimit dhe mësues të shkollës. Drejtori i shkollës “Hamit Sejdiu”, Qefser Behrami, ka



falënderuar bashkëpunëtorët që ndihmuan për realizimin e kësaj monografie, e cila i mbeti ëndërr e përealizuar e autorit, mësues të ndjerë të kësaj shkolle, Milazim Kadriu, por që për jetësimin e saj u angazhua i biri i autorit, Përparim Kadriu.

Ish-presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu, ka përgëzuar për punën e bërë për promovimin e monografisë, duke thënë se autori i saj, Milazim Kadriu, është i gjallë mes neve, nga fjala dhe përkushtimi i tij, edhe pse fizikisht nuk e kemi këtu.

Komuna e Vitisë bëhet pjesë e një pilotprojekti për personat me aftësi të kufizuara fizike

VITI, 7 MARS (ER) - Komuna e Vitisë është përzgjedhur përfituese për realizimin e një pilotprojekti për mundësinë e identifikimit të qasjes fizike të personave me aftësi të kufizuara fizike në të gjitha objektet publike dhe private, me qëllim të mosdiskriminimit dhe integritit të tyre në shoqëri. Kjo u bë me dije nga Venera Çerkini, udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe

Monitorim të komunave, e cila është pritur në takim nga kryetari i Komunës së Vitisë, Sokol Haliti, me bashkëpunëtorë. Në këtë takim kryetari Haliti ka theksuar se ky projekt për të ka një rëndësi të veçantë pasi, sipas tij, me atë do të përfitojnë qytetarët me nevoja të veçanta. Ai ka theksuar se Komuna e Vitisë do të bëjë çmos që realizimi i tij të jetë sa më i mirë.



NLB Banka dhuron printer për shkolla të Komunës së Drenasit

DRENAS, 7 MARS (ER) - Drejtori i Drejtorisë së Arsimit, Muhamet Gjoka, së bashku me udhëheqësin e “NLB Banka” në Drenas, Shemsi Kadriu, kanë shpërndarë printerë në shkollat e Komunës së Drenasit, ku NLB ka dhënë donacion gjashtë printerë/skanerë për

gjashtë shkolla. Me këtë rast, drejtori Gjoka ka falënderuar Shemsi Kadriu, udhëheqësin e “NLB Banka” në Drenas, për dhurimin e këtyre pajisjeve teknologjike të cilat do t'i ndihmojnë shkollat për kryerjen e shërbimeve më cilësore.

Së shpejti fillon ndërtimi i urës mbi lumin Sitnica në Rufe të Ri të Lipjanit

LIPJAN, 7 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, së bashku me ministrin e Infrastrukturës, Arban Abrashi, kanë nënshkruar memorandum mirëkuptimi për financimin e disa projekteve në Lipjan. Në këtë memorandum parashihet që të

bëhet ndërtimi i urës mbi lumin Sitnica në Rufe të Ri, po ashtu këtë vit do të bëhet edhe asfaltimi i rrugës “Marie Shllaku”. Kryetari Ahmeti u shpreh se këto projekte janë të mirëseardhura për qytetarët e Komunës së Lipjanit.



KUR THEMI 'PREKAZ'!



Isa FERIZAJ

Në historinë e një kombi ka emra vendesh, emra njerëzish, apo ngjarjesh madhore historike që kanë lënë, apo lënë gjurmë të pashlyeshme në kujtesën e kombit. Kështu mund të përmendim emrin e Krujës legjendare, bashkë me emrin e Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastriotit – Skenderbeut; emrin e Epokës Skenderbegiane; emrin e Epokës së Rilindjes tonë Kombëtare, bashkë me emrat e rilindësve që ndriten me dritën e Diellit në qiellin e mbuluar nga retë e pushtimit në një nga kohërat më të errëta e më të gjata nën pushtimin osman të kombit e truallit tonë; emrin e Ismail Qemalit e të veprës së tij atdhetare, Shpalljes së Pavarësisë; emrin e Luftës së Vlorës e të Selam Musa Salarisë; emrin e Revolucionit Demokratik të vitit 1924 dhe të Bajram Currit e Fan Nolit, Avni Rustemit, Hasan Prishtinës e Luigj Gurakuqit; emrin e Epopesë më të lavdishme të historisë së kombit tonë, atë të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, së bashku me emrin e Heroit Kombëtar, Enver Hoxha, si organizatori, ideatori, frymëzuesi, udhëheqësi, strategu i fitoreve të njëpasnjëshme të popullit shqiptar në afro një gjysëm shekulli (në gjysmën e dytë të shek. XX); emrin e PKSH (PPSH) në lidhje të ngushtë me emrin e themeluesit të saj, udhëheqësit të saj largpamës, trim e të guximshëm, burrshtetasit legjendar, diplomatit brilant e të urtë, komandantit të përgjithshëm të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare, njeriut më të madh të kombit që e nxori atë nga errësira shumëshekullore mesjetare, në dritën e vertetë të lirisë e të emancipimit shoqëror, birit më të dashur të të gjitha zemrave të verteta shqiptare, qendrestarit të pashoq në historinë bashkëkohore moderne e atdhetarit më të vendosur në mbrojtjen e kombit, atdheut e të vlerave të shqiptarisë, Enver Hoxhës. Po kështu, kur përmendim emrin e Kosovës heroike, nuk mund të mos

permendim emra të mëdhenj vendesh, ngjarjesh e figurah historike me peshë gjithëkombëtare, si: Prizrenin me Lidhjen Shqiptare e me emrat e mëdhenj të Abdyll Frashërit, Ymer Prizrenit e, Sylejman Vokshit; emrin e Boletinit me emrin e “Robin Hudit” shqiptar, Isa Boletinit; emrin e Drenicës, së bashku me emrat e Azem Galicës e Shote Galicës, emrin e çdo pëllëmbë toke shqiptare aty, së bashku me emrat e mëdhenj të Tahir Mehës, Shaban Polluzhës, Emin Durakut, Rexhep Malës, Isuf Gervallës e Kadri Zekës, Afrim Zhitisë e Nuhi Berishës, etj., etj. Por, një emer në trojet tona, sa të lashta edhe me histori të reja të pashoq askund në këtë botë “moderne”, për nga heroizmi, nderi e krenaria, lavdia e pavdekësia, si ai i PREKAZIT të Drenicës legjendare, nuk mund të mos përmendet në këto kohëra e në ato që do të vijjnë, si emri që meriton aq nderim e mirënjohje nga i gjithë kombi ynë. Kur themi PREKAZ, mendja jonë lidhet logjikshëm me ngjarjen që shenoi kthesën më të madhe historike në kahun e shqiptarëve, ngjarjen që me të drejtë mund ta krahasoj me “Betejën e Stalingradit” në Luftën e Dytë Botërore, që edhe ajo përcaktoi fatin e shpëtimit të njerëzimit kudo në botë, nga shfarosja prej bishës nazi-fashiste hitlerjane. Prekazi legjendar, ky fshat shqiptar e plot atdhetari e shqiptari, në pranverën e vitit 1998, në atë fillim marsi, sa tragjik, aq edhe heroik e lavdimadh, trokiti në ndergjegjen e Kombit me më të mirën vlerë

që kombi kishte mundur ta ruajë, të përcjellë nga një brez tek tjetri, shekujve të robërisë e kohërave të qendresës, me atë vlerë që vetëm trimat shqiptarë dinë ta përdorin e ta çmojnë si jetën e tyre, më QENDRESËN legjendare gjithëpopullore kundër një ushtrie të një shteti barbar e më antishqiptari në histori, të armatosur gjerë në dhëmbë me armatimin më modern të kohës, siç ishte ushtria pushtuese çnjerëzore, serbe e asaj kohe. Prekazi legjendar, u bë i tillë edhe falë një akti madhor, të paparë askund në historinë e kombeve shumë më të mëdhenj se ai i yni, atij të flijimit të ndergjegjshëm të 56 pjesëtarëve të një familjeje heroike e legjendare shqiptare, për një çështje të shenjtë, siç ishte Çlirimi i Kosovës dhe i popullit shqiptar nga robëria shekullore serboçnjerëzore. Kjo familje e madhe, jo për nga numri i anëtarëve që ia fali lirisë, pasi ky numer ishte me të vertetë shumë i madh, por për nga madhështia e vlerave që ia fali shqiptarisë, ishte familja e Shaban Jasharit, biri i të cilit, Adem Jashari, u shndërrua në ditët më të errëta të robërisë, në diell, në shpresë, në guxim, në burrëri e pathyeshmeri shqiptari të vertetë, që u vu në ballë të luftës çlirimtare të shqiptarëve atje, që u vu në krye të UÇK-së së pathyeshme e, të pavdekshme, fitimtare e legjendare. Prekazi dhe emri lavdimadh i Familjes JASHARI u shndërruan shumë shpejt në zemren e kujtesën e pashlyeshme të mbarë kombit, si vendi e simboli ku kombi përulet para tyre me nderim të


pashoq, perulet para qendrestarisë e shembelltyres heroike të tyre, sepse ky fshat me emer nderi në historinë tonë kombëtare moderne e, kjo familje e madhërishtme, gjak i gjakut të kulluar të rracës shqiptare, u shndërruan në kryeqytetin e kohërave moderne të shqiptarisë e, në simbolin frymëzues, plot lavdi të rracës shqiptare midis rracave të njerëzimit të të gjitha kohërave. Kur themi PREKAZ, kemi thënë Shqiperi, kemi thënë Krujë e Prizren, Vlorë e Kaçanik, Tiranë e Prishtinë, Shkodër e Gjakovë; Ulqin e Manastir; Janinë e Mollë e Kuqe; Preshevë e Durrës. Prekazi është vendlindja e EPOPESE më të lavdishme të UÇK-së dhe Luftës së saj legjendare Çlirimtare; është vendi ku çdo vrimë në shtepitë e tij, hapur prej plumbave dhe predhave të armikut, u shndërrua në fole jete. Nga ato predha e plumba nuk u shua jeta shqiptare. Në ato “fole” rilindi jeta, ato u shndërruan në fole shqiptarësh, ku nënat shqiptare rilindën jetët e reja, rilindën trimerinë e lavdinë, bash si shqiptarët krenarë, kur lindin e rritin bijtë e vet në çerdhet e tyre të pamposhtura, sulmuar nga rrebeshet e natyrës. Them i “Prekaz” dhe menjëherë mendja na shkon tek kjo Europa e sotme që nuk pati kurr kurajon të denojë padrejtësitë e plagët e shumta e të përgjakura që ia shkuktoi kombit tonë, ajo Europa “e vjeter”, nënë e kësaj të sotmes. Prekazi, është aktakuza më e rëndë që kombi ynë i ka bërë histories e asaj Europës plakë, aktakuzë nga e cila as

Europa e sotme, as “drejtësia” nderkombëtare, nuk mundën e, as do të mund të çlirohen, pa i çuar në zgjidhje të drejtë e të plotë të gjitha padrejtësitë që na i kanë bërë ata si komb. Prekazi është thirrja e ndergjegjës së shëndoshë atdhetare shqiptare, për të mos harruar dhimbjet që na shkaktoi historia, për të degjuar zërin e deshmorëve e të heronjve të kombit, rënë në altarin e lirisë e të lavdisë, në të gjitha kohërat; është kushtim që pisket në qiellin e shqiptarisë, deri në plotësimin e amanetit të të rënëve të nderit, atë të Ribashkimit të Kombit e të trojeve tona. Vetem, kështu, e kemi të drejtën morale që ta përmendim e ta therrasim, kudo e kurdoherë, emrin e Prekazit të Drenicës së Kosovës – Shqiperi, heroike e lagjendare.

Sot në 23 -vjetorin e Epopesë së lavdishme e emer madhe të Prekazit, kush e di se sa djem shqiptarë mbajnë me nder e me krenari, emrin “Prekaz”, çka flet për atë depertim të thellë në ndergjegjen e kombit tonë të lavdisë së këtij fshati shqiptar. Ky fhat, është fshati i vetem në botë, si “kryeqyteti” i lavdisë e i nderit të një vendi, kombi, vlerësim ky i plotmerituar. Kur themi “PREKAZ”, kemi thënë LAVDI, ne flasim me historinë, me krenarinë, me shqiptarinë, me pavdekësinë kombëtare, prandaj, brezat e sotëm duhet ta përcjellin tek ata që vijjnë pas tyre si kryevlerën e rracës së tyre, që detyroi botën e padrejtë ndaj nesh, që të bjerë në gjunjë para mrekullisë e shpirtmadhësisë shqiptare, por që, edhe zgjoi nga gjumi botën “mike” për ta degjuar zërin e zemren tonë, për ta kuptuar e mbështetur atë në momentet më të veshitura për kombin. Prekazi është emri që lidh majmalet e lavdisë së historisë së kombit tonë, është libri më i madh që u shkrua vetem me gjak shqiptarësh dhe, që s’lejon askënd që ta keqlexojë apo ta rishkruajë ndryshe nga ç’e shkroi familja e kryelegjendarit e Komandantit vigan të UÇK-së, Adem Jasharit. Prekazi është Kosova, është Lugina e Preshevës, është trualli ynë mbetur në Maqedoni, është Çameria, është toka shqiptare mbetur tragjikisht në Mal të Zi e, mbi të gjitha është Shqiperia natyrore dhe shqiptaria.

Tiranë, më 06 mars 2021





EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Drita rikthehet në krye të Superligës, Prishtina nuk gaboi ndaj Llapit

Ekipi i Dritës, i cili kampion në fuqi, është rikthyer në krye të Superligës, pasi të dielën ka mposhtur Feronikelin. Në këtë xhiro nuk ka gabuar as Prishtina që ka fituar në përballjen me Llapin



akordonte faull. Kjo nuk është aspak në rregull sepse, mbi të gjitha, nuk i kontribuon lojës së futbollit dhe lojës së 'fair-play'-t të cilën e promovojmë", ka thënë pas ndeshjes, Klodian Duro, trajner i Feronikelit.

Ndërsa të shtunën Prishtina e ka vazhduar serinë pozitive në stinorin pranveror, duke realizuar fitoren e pestë radhazi. Kryeqytetasit shënuan fitore në stadiumin "Fadil Vokrri" kundër

Llapit (2-0). Besnik Krasniqi dhe Alban Shillova ishin shënues për Prishtinën, kurse pas kësaj ndeshje "bardhekaltrit" renditen në pozitën e tretë dhe kanë grumbulluar 47 pikë. Në anën tjetër, Llapi është në pozitën e shtatë me 26 pikë. Në ndeshjen tjetër Gjilani dhe Arbëria u ndanë baras, 1-1. Të dyja golat në këtë ndeshje u realizuan në pjesën e dytë. Në minutën e 61-të Agron Bruqi i Arbërisë, në tentim për ta

SUPERLIGA - Java 23

Feronikeli - Drita	0-1
Prishtina - Llapi	2-0
Gjilani - Arbëria	1-1
Besa-Trepça '89	1-2
Ballkani-Drenica	2-1

Tabela

	Pikë
1. Drita	23
2. Ballkani	23
3. Prishtina	23
4. Gjilani	23
5. Trepça '89	23
6. Feronikeli	23
7. Llapi	23
8. Arbëria	23
9. Drenica	23
10. Besa	23

Në xhiron e radhës takohen: Arbëria - Ballkani, Llapi - Drenica, Drita - Gjilani, Trepça '89 - Feronikeli, Prishtina - Besa.

larguar topin, shënoi autogol për t'ua dhënë epërsinë gjilanasve, por mysafirët nga humbja i shpëtoi Marclei Santos, me golin e shënuar në minutën e 84-t. Gjilani vazhdon të mbetet në pozitën e katërt me 33 pikë, kurse Arbëria në vendin e tetë me 26 pikë.

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 7 MARS 2021 - Kampionia në fuqi e Kosovës në futboll, Drita, e ka fituar derbin ndaj Feronikelit me rezultat 0-1, në ndeshjen e zhvilluar të dielën në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas. Trajneri i Dritës, Ardian Nuhiu, pas fitores kundër Feronikelit ka thënë se fitorja ishte e merituar dhe se Alidema është shpërblyer për punën e madhe që ka bërë ditët e fundit. "E kemi ditur që do të jetë ndeshje e vështirë. Kemi pasur rastin ta ndëshkojmë me kundërsulme. Kemi qenë më kërkues dhe kemi luftuar shumë dhe në fund u shpërblyem me fitore. Goli në këto minuta sjell emocione më shumë. Më gëzoi fakti që realizoi Festim Alidema, pasi ka punuar shumë për këtë

ditë dhe më vjen mirë që i erdhi goli", ka thënë Nuhiu.

Në këtë ndeshje rastet nuk munguan në pjesën e parë e as në të dytën, por goli i vetëm u shënuar në minutën e katërt shtesë, kur Festim Alidema realizoi një gol të bukur.

Drita me tri pikët e reja rikthehet në krye të elitës me 50 pikë të grumbulluara, kurse "Nikli" mbetet në pozitën e 6 me 27 pikë. "Rregullat janë të qarta, kur futbollisti ka dorën e hapur dhe prek topin me dorë, është penalti. Gjyqtari na tha që ua fala një rast një minutën e 40 dhe jemi barazim. Këtu nuk ka barazim të rasteve, sepse po të shënonim loja do të ishte më ndryshe. Drita kishte udhëtuar me taktikë të veçantë. Në çdo ndërprerje futbollistët e kësaj skuadre shtriheshin dhe gjyqtari

Trepça regjistron fitore ndaj Bashkimit

MITROVICË, 7 MARS - Trepça ka shënuar fitore ndaj Bashkimit me shifrat 88:72 (26:13, 17:29, 23:14, 22:16), në kuadër të javës së 22-të në FIVE STAR Superligën e Kosovës në basketboll. Pas rezultatit 0:4, vendasit me një seri prej 11:0, morën lojën në duar dhe ishin më të mirë në



çerekun e parë, duke e përmblytur me shifrat 26:13. Por, mysafirët nga Prizreni, u kundërpërgjigjën në periudhën e dytë, duke e fituar 17:29, duke shkuar në pushim me rezultat 43:42. Mitrovicasit ishin për një nuancë më të

mirë në periodën e tretë, ku pas një lojë të baraspeshuar, në dy minutat e fundit vendasit shkëputen në 10 pikë epërsi, 66:56, sa ishte rezultati pas 30 minutave. Në 10 minutat e fundit, 'Xehetarët' thelluan edhe më shumë

epërsinë, ku më e larta ishte 26 pikë, 82:56, kurse prizrenasit nuk arritën të bëjnë më shumë sesa të ngushtojnë shifrat, derisa Trepça triumfoi në fund 88:72. Te Trepça u dalluan Ivan Koljeviq me 24 pikë e 9 asistime, Drilon Hajrizi me 16 pikë, 10 kërcime e 10 asistime dhe Besnik

Azemi me 17 pikë e 5 kërcime, kurse te Bashkimi u dalluan Christian Lutete me 28 pikë e 9 kërcime dhe Obinna Oleka me 13 pikë e 24 kërcime. Trepça tani ka 9 fitore dhe 13 humbje, kurse Bashkimi 10 fitore dhe 12 humbje.

S'ka fitues në derbin e Madridit

MADRID, 7 MARS - Derbi i Madridit mes Atletico dhe Realit u mbyll në barazim 1-1, duke mbajtur distancën prej 5 pikësh mes tyre, ndërkohë që ky rezultat i buzëqesh më shumë Barcelonës. "Los Colchoneros" e nisën



mjaft mirë ndeshjen duke zhbllokuar rezultatit në minutën e 15-të me Luis Suarez. Dy minuta nga fundi sulmuesi francez bën gjithçka mirë në zonë dhe pas një kombinimi me Casemiron e dërgon topin në rrjetë. Pas këtij barazimi Atletico mbetet në krye me 58 pikë, 5 më

shumë se Reali, por ka Barcelonën vetëm dy pikë larg. Skuadra e Simeones mund të ngushëllohet me faktin që ka edhe një tjetër sfidë për të rikuperuar në kampionat, teksa në javët e fundit nuk ka pasur stabilitetin e nevojshëm duke humbur shumë pikë ndaj Levantes

Unitedi fiton derbin e Manchesterit

Manchester, 7 mars - Me titullin thuajse të siguruar, Manchester City është sforcuar pak në derbi, duke u mundur 2-0 nga

Manchester United. Skuadra e Pep Guardiols i dha fund ecurisë së 21 fitoreve radhazi në të gjitha kompeticionet. Bruno Fernandes

zhbllkoi rezultatit që në minutën e 2-të me 11-metërsh ndërkohë që në fillimin e pjesës së dytë mbrojtësi Luke Shaw vulosi

fitoren e ekipit të Solskjaer. United me këtë fitore ngjitet në vendin e dytë me 54 pikë, 11 më pak se City kryesues.



Halilaj konfirmohet kryetar i FGJK-së, nënkryetare zgjedhën Bregu dhe Aliqkaj-Qerimi

PRISHTINË, 7 MARS - Federata e Gjinnastikës e Kosovës ka mbajtur Kuvendin Zgjedhor, në të cilin janë zgjedhur drejtuesit e kësaj federate. Besim Halilaj është konfirmuar edhe për një

mandat kryetar, kurse nënkryetare janë zgjedhur Abelianë Bregu dhe Sherife Aliqkaj-Qerimi. "Pozita e kryetarit të FGJK-së iu besua edhe për një mandat Besim Halilajt, kurse

nënkryetare e parë u zgjodh Abelianë Bregu dhe nënkryetare e dytë, Sherife Aliqkaj-Qerimi, ndërsa sekretar gjeneral i FGJK-së edhe për një mandat u zgjodh Amir Tahiraga, që të

gjithë me vota absolute, pa asnjë votë kundër apo abstenim. Po ashtu, kuvendi zgjodhi edhe kryesinë, bordin e ri dhe organet e tjera", thuhet në njoftimin e FGJK-së.



Muça mposhti kancerin dhe iu kthye fushës

PRISHTINË, 7 MARS - Rrëfimi prekës i futbollistit të Prishtinës, Gentian Muça, i cili tregon se besimi në Zot e ndihmoi ta fitonte betejën me kancerin. E fitoi betejën më të vështirë në jetë. Ishte korriku i vitit 2017 kur futbollisti Gentian Muça u diagnostikua me kancer. Futbollisti tashmë i Prishtinës rrëfen se gjendja e tij në atë kohë ishte e pashpresë por, ia doli. "Një gjë të tillë nuk ia dëshiroj as armikut t'i ndodhë por, erdhi dhe duhet të përballesha me të. Falë besimit në Zot, familjes dhe mbështetjes që më dha opinioni sportiv në Shqipëri, arrita të përballesha me sëmundjen dhe falë Zotit sëmundja ishte e kurueshme. Trajtimi që më kanë bërë në Itali ishte i suksesshëm dhe u shërova", ka thënë për "RTV Dukagjinit", Gentian Muça. Ish-kapiteni i Tiranës arriti të kthehej në fushë pas 717 ditësh. "Pas gati një viti e gjysmë nga një operim në tjetrin, nga një spital në tjetrin, arrita të rikthehem. Rreziku ishte i madh pasi, përtej



sëmundjes, kisha një protezë brenda në kockë dhe rreziku i thyerjes ishte i pranishëm", ka shtuar ai.

Muça ka një mesazh për të gjithë ata që një ditë mund të kalojnë sfida të tilla. "Është e vërtetë që në fillim kam qenë i ndrojtur, por më pas vendosa ta bëj publike. E rëndësishme është që të kesh afër njerëzit e duhur dhe të mos humbasësh shpresën. Mrekullitë

mund të ndodhin dhe mund t'ia dalësh me besim", ka deklaruar Muça. Dy ekipet kryeqytetase, sipas Muçës, pos ngjyrave, kanë edhe një tjetër element të përbashkët. "Presioni është i njëjtë si në Tiranë, po ashtu edhe në Prishtinë në krahasim me skuadrat e tjera". Muça thotë në Kosovë do të ketë garë mes tri ekipeve për titull të kampionit.

Tirana mposht edhe Kastriotin, Teuta ndalet nga Bylisi

TIRANË, 7 MARS - Tirana ka mposhtur Kastriotin me rezultatin 2-1 në ndeshjen e vlefshme për javën e 23-të në Kategorinë Superiore. "Bardheblutë" regjistrojnë kështu fitoren e tretë radhazi, e cila ndodh për herën e parë në këtë sezon. Goli i Taulant Seferit në minutën e 20 me penallti dhe "perla" e Erjon Hoxhallarit në minutën e 59 nga goditja e dënimit, e bënë të pavlefshëm golin e De Silvës në minutën e 66. Ishte një ndeshje e barabartë nga të dyja skuadrat, të cilat kishin disa raste shënimi, por "bardheblutë" u treguan më të saktë. Kryeqytetasit ngrehen në kuotën e 35 pikëve në vendin e 5-të dhe i dërgojnë mesazh Partizanit, me të cilin do të luajnë në xhiron e ardhshme në derbin e kryeqytetit. Kastrioti mbetet në kuotën e 28 pikëve në vendin e 7-



të. Dominimi i Teutës kundër Bylisit nuk është shpërblyer, pasi ndeshja në Ballsh është mbyllur në barazim 1-1. Pas gjysmë ore lojë Teuta fitoi një penallti dhe Dejvi Bregu nga pika e bardhë e penalltisë nuk gaboi dhe e çoi topin në rrjetë. Bylisi nuk mund ta pranonte disavantashin dhe u

hodh në sulm për të shënuar. Nuk u desh shumë kohë dhe ballshiotët ia dolën të realizonin me anë të nigerianit Anthony. Pas një topi të marrë nga Arbër Mehmetllari, sulmuesi u tregua i saktë dhe e mposhti portierin Frashëri. Ndryshim rezultati nuk pati as në pjesën e dytë dhe skuadrat ndanë pikët.

SHKURT

Khaka: Më vjen keq për gabimin, por ky është futbollit

Arsenali e mbylli në barazim 1-1 sfidën kundër Burnleyt. Mysafirët kaluan shumë shpejt në avantazh me anë të kapitenit Aubameyang (6'), por një gafë e Granit Xhakës ndikoi që Burnley ta barazonte ndeshjen në minutën e 39. "Më vjen keq për gabimin, por ky është futbollit. Për momentin ndihem po aq i irrituar sa të gjithë ju", ka deklaruar mesfushori shqiptar Granit Xhaka.

Gazetari italian: Gattuso i beson Hysajt

Në fund të sezonit do ta shpallë divorcin përfundimtar me Napolin, por kjo nuk e ka penguar Rino Gattuson ta aktivizojë Elseid Hysajn në fushën e lojës. Madje, duke dalë edhe kundër presidentit De Laurentis, i cili kërkon që shkodrani së bashku me Maksimoviçit të qëndrojnë në stol për vetë faktin se kontrata e tyre skadon për vetëm disa muaj. Por fjalët e kreut të klubit italian kanë rënë në vesh të shurdhët, pasi Gattuso duket se ka një besim të palëkundur te mbrojtësi shqiptar. Gazetari i "RAI"-t, Çiro Venerato, ka folur për "Radio Kiss Kiss Napoli" mbi këtë çështje, duke u shprehur se kreu i bankinës i beson Hysajt, ndërsa shton se ky i fundit e di mjaft mirë sa fjalë pozitive ka marrë nga Gattuso për rikonfirmimin e tij te Napoli. "Gattuso i beson Hysajt dhe Maksimoviçit sepse ai vetë kërkoi t'i mbante lojtarët dhe t'i zgjaste kontratat e tyre. Ata luajnë sepse e dinë që kanë besimin e trajnerit. Janë shumë afër trajnerit dhe Hysaj e di sa fjalë të bukura shpenzoi Gattuso për rikonfirmimin e tij", ka thënë Venerato.

Pirlo: Reagam si skuadër e madhe ndaj Lazios

Juventusit fitoi kundër Lazios me përmbysje (3-1), kurse trajneri Andrea Pirlo u shpreh mjaft i lumtur me fitoren, mbi të gjitha me sjelljen në fushë të futbollistëve të tij, teksa më pas bëri apel që të fillojnë të mendojnë për ndeshjen ndaj Portos në Ligën e Kampionëve. "E nisëm keq ndeshjen, duke i dhuruar 20 minutat e para, megjithatë reagimi ishte prej një skuadre të madhe. Erdhëm duke e rritur ritmin vazhdimisht dhe duke shtuar presionin ndaj kundërshtarit, që i lamë shumë pak mundësi. Më pëlqeu mentaliteti me të cilin përballuam këtë sfidë, por tani duhet të çlodhemi dhe të mendojmë për Porton, pasi ajo është një ndeshje ku gabimet janë të ndaluara", ka thënë Pirlo.

Pochettino e kërkon De Gean

Trajneri i Paris Saint Germainit, Maurizio Pochettino, është duke kërkuar që ta përforcojë skuadrën me një portier të klasës botërore. Keylor Navas nuk e ka bindur argentinasi, i cili ka shfaqur interesim për portierin e Manchester Unitedit, David De Gea. Sipas "The Sun", De Gea mund të jetë lojtar i PSG-së pasi çdo ditë e më shumë Dean Henderson po merr vëmendje me paraqitje të mira në Manchester dhe tani ai kërkon minuta, në të kundërtën do të largohet nga klubi.

Muller, Hummels dhe Boateng, afër rikthimit te Gjermania

Vendimi për të lënë jashtë emra si Thomas Muller, Mats Hummels dhe Jerome Boateng nga Kombëtarja e Gjermanisë ka shkaktuar shumë bujë dhe polemika prej kohësh. Paraqitjet

fantastike të Mullerit me Bayernin, por edhe të Boatengut e Hummelsit, kanë bërë që tifozët dhe shtypi të ushtrojnë shumë presion te trajneri Low. Gjermania ka qenë shumë e dobët në

repartin e mbrojtjes, me "Pancerat" që u mposhtën 6-0 nga Spanja, që ishte edhe pika më e ulët e tyre në gjithë këto vite. Rikthimi i treshes Hummels-Boateng-Muller duket një

domosdoshmëri tashmë dhe Low ka folur në lidhje me këtë temë së fundmi. Trajneri i kombëtares është shprehur për "Sky" se po e mendon seriozisht rikthimin e gardës së vjetër dhe në muajin

maj do të ketë një vendim final. Mediat raportojnë se të tre lojtarët do të rikthehen në kombëtare dhe do të jenë të gatshëm për Evropianin që zhvillohet këtë verë.

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymer Kelmendi

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjizë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

Një libër që zbrërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

Daut Dauti


AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI

AGRON SHALA

DEKALOGU

『nga Moisiu deri te Kieślowski』

ÇMIMI: 5.99 €



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjstruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuues i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

Një palë këpucë në Berlin është novela e tij e parë.

4⁹⁹ €



Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë





K.R.U. "Drini i Bardhë" SHA
Rr. Mbretëresha Teutë nr.85
www.krudinibardhe.com

Në bazë të rregullores mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e punëve dhe detyrave të punës, KRU "Drini i Bardhë" Sh.A, me datën 08.03.2021 shpallë këtë:

KONKURS

Pozita: Menaxher i njësisë operative, vendi Klinë (1 pozitë) dhe Deçan (1 pozitë).

Detyrat e punës janë:

- Menaxhon më njësinë operative, harton propozim planin vjetor të punës dhe kujdeset për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e aseteve, përcjell realizimin e planit vjetor, është përgjegjës për disiplinën në punë dhe azhurnimin brenda njësisë.

Kushtet për themelimin e marrëdhënies së punës:

- Diploma universitare drejtimi ekonomik, bujqësisë ose juridik,
- Përvoja e punës prej 3 viteve në vende të ngjashme të punës.

Pozita: Përgjegjës për operim të ujërave, Vendi Pejë, (1 pozitë).

Detyrat e punës janë:

- Planifikon, distribuon të gjitha sasirat e ujërave, mbikëqyrë realizimin e kontratave për shfrytëzimin e ujërave, kontrollon sasirat e ujit të kontraktuar dhe realizimin e tyre, jep mendime profesionale dhe jep urdhra për ujitje dhe ndërprerje të ujit për ujitje, merr masa të nevojshme që uji i ujitës mos të ndotët, propozon masa mbrojtëse për vërshime.

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

- Fakulteti i Bujqësisë, ose Ekonomik,
- Përvoja e punës prej 3 viteve.

Pozita: Inkasantë sezonal për teren, Vendi Pejë: (4 pozita), Deçan: (3 pozita), Gurrakoc: (3 pozita).

Detyrat e punës janë:

-Bëjnë pastrimin e kanaleve të ujitjes sipas planifikimit nga Menaxheri i Njësisë, bëjnë kontraktimin e ujit, shpërndarjen e ujit, dhe pagesat nga fermerët, më rastin e pagesave janë të obliguar të lëshojnë kontrata dhe dëftesat e pagesave.

Kushtet për themelimin e marrëdhënies së punës.

- Kualifikimi i mesëm shkollor,
- Përvoja e punës 1 vjeçare, ne lami të ngjashme.

Pozita: Përgjegjës për hurdhata e peshkut dhe seperacione (1 pozitë) Vendi Istog.

Detyrat e punës janë:

- Duhet të jete ne gatishmëri 24 orë, ndaj kërkesave të hurdhave dhe seperacioneve për shërbimet të cilat i ofron kompania ndaj tyre.

Kushtet për themelimin e marrëdhënies së punës.

- Kualifikimi i mesëm shkollor,
- Përvoja e punës 1 vjeçare, ne lami të ngjashme.

Pozita: Vozitës – Përgjegjës për eskavator (2 pozita) Vendi Pejë.

Detyrat e punës janë:

Vozitësi, organizon dhe koordinon punën me eskavator dhe kujdeset për mirëmbajtjen e tij, Propozon masa mbrojtëse ne vend të punës dhe jep llogari për punët e kryera.

Kushtet për themelimin e marrëdhënies së punës.

- Shkolla e Mesme,
- Përvoja e punës 2 vjeçare në vozitje të eskavatorit.

Procedura e aplikimit:

Dokumentet dorëzohen ne zyrën nr. 1 të KRU "Drini i Bardhë" rruga "Mbretëresha Teutë" Nr. 85 Pejë.

Aplikacionit duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:

- CV-ja (Biografia),
- Kopja e letërnjoftimit, dëshminë e përvojës se punës,
- Diplomën shkollore për kualifikimin e kërkuar - kopje,
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj.

Afati për dorëzimin e aplikacioneve është 15 ditë nga dita e publikimit të konkursit dhe përfundon në ora 16:00, të ditës gjegjëse.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine
Ministry of Economy and Environment

Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë
për Kushtet Ndërtimore

"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin "Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".

Nr. prot: 506/21 të datës 05.02.2021, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

Posta rekomandë:

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë
Ndërtesa e Rilindjes
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:

<http://mmp-hks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor
Suzana.goranci@rks-gov.net
Telefon: + 381 38 200 32 553

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► "Icon Group" shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330407701, Ilir Llapashtica.

► Gent Pllana shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 6-9 të shkollës fillore "Enver Hadri"

► Sadije Ferizi shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 8-të të shkollës fillore "Fazli Grajqevci"

► Refki Brahimi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Bislim Imeri"

► Islam Bollopoja shpall të pavlefshme diplomën e SHMLT "Arkitekt Sinani"

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet,

kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

